

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Papa Leone XIV përfundon takimet në Paris dhe niset drejt Lourdes: 700 mijë besimtarë në meshe
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/papa-leone-xiv-perfundon-takimet-ne-paris-dhe-niset-drejt-lourdes-700-mije-besimtare-ne-meshe/1028568/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 15:15:24 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 15:10:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2df4bac8229280e60941f1c9b6830209a463bf59648680ff258835d44d5a2fad
TEKSTI	95d1e9f70539c8535d4996821e2c920bfbe2bfdba3ad5fc7a69c5c5e0be53392
PAMJA	ea811afb6448612f9de70fc07202f06e3621c8f382ae757e6734e6ad8f2c0f9a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	94b208651794fa4ecaab3cf6a499ef787d905ae66bef17b98bc148ac0f1770ab
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c646a932fde53c288233dea515333d4375993381cb212e1a0a5e6c9db33460b4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/94b208651794fa4ecaab3cf6a499ef787d905ae66bef17b98bc148ac0f1770ab>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Papa Leone XIV përfundon takimet në Paris dhe nisjet drejt Lourdes: 700 mijë besimtarë në meshë



Vizita apostolike e Papa Leones XIV në Francë vijoi të shtunën, më 26 shtator, me një sërë takimesh në Paris. Pas angazhimeve në kryeqytet, kreu i Kishës Katolike u nis drejt Lourdes, një prej qendrave më të rëndësishme të pelegrinazhit katolik.

Programi i paradites përfshiu vizitën në qendrën e pritjes "Maison Bakhita", ku Papa u takua me përfaqësues të komunitetit të migrantëve. Më pas, ai zhvilloi një takim në Institutin Katolik të Parisit me katekumënët, të rritur që përgatiten për të marrë sakramentin e pagëzimit.

E themeluar në vitin 1818 nga Kryedioqea e Parisit, "Maison Bakhita" synon të mbështesë pritjen dhe integrimin e migrantëve.

Gjatë qëndrimit në këtë qendër, Leone XIV kujtoi Shën Bakhitën, ish-sklaven sudaneze që u shpall shenjtore, duke nënvizuar kontributin e grave në ndërtimin e një "qytetërimi të dashurisë". Ai shprehu mirënjohje për personat që punojnë aty dhe vuri theksin te nevoja për ambiente ku njerëzit të gjejnë mbështetje, besim dhe shpresë.

"Askush nuk është aq i varfër sa të mos ketë diçka për të dhënë; askush nuk është aq i pasur sa të mos ketë diçka për të marrë", tha Papa.

Gjatë takimit me katekumënët, Papa deklaroi se ishte befasuar nga numri i njerëzve që po afrohen përsëri me besimin, veçanërisht nga të rriturit që kërkojnë të marrin sakramentet e inicimit të krishterë.

Sipas tij, ky zhvillim merr një rëndësi të veçantë në Francë, ku shoqëria karakterizohet nga një nivel i lartë sekularizimi. Ai e përshkroi përvojën e këtyre personave si një dëshmi të gjallë të veprimit të hirit të Zotit, përtej

të fundit /



VIDEO/ Kuqezinjtë këndojnë e kërcëjnë para përballjes me...



PD i kërkon Peleshit zbatimin e vendimit të Kushtetueses për...



A është në një lidhje? Egli Tako i përgjigjet kureshtjes së fansave



Pula: UÇK-ja përfaqëson një kapitull vendimtar të historisë...



Tragjedia në Athinë: Katër shqiptarë humbën jetën nën...



Modeli statistikor projekton Shqipërinë si fituese të grupit dhe...



Lamine Yamal zbulon prapaskenat e finales së Botërorit 2026: Ish...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

shpjegimeve statistikore dhe sociologjike.

Të dhënat e Konferencës Ipeshkvnore Franceze tregojnë se gjatë Pashkëve të këtij viti në Francë u pagëzuan 21,386 katekumënë. Prej tyre, 13,234 ishin të rritur dhe 8,152 adoleshentë.

Numri i përgjithshëm shënoi një rritje prej rreth 20% në raport me vitin 2025. Te të rriturit rritja ishte rreth 28%, ndërsa te adoleshentët rreth 10%.

Leone XIV u kërkoi komuniteteve katolike që afrimin e të rinjve dhe të rriturve me besimin ta shoqërojnë me një formim të përshtatshëm shpirtëror.

Gjatë pasdites, Papa kremtoi meshën në Place de la Concorde. Ceremonia u ndoq nga rreth 700 mijë besimtarë, ndërsa një numër i madh njerëzish e pritën atë përgjatë Champs-Élysées, nga Harku i Triumfit deri në shesh, me flamuj dhe himne.

Në fjalën drejtuar të rinjve, Papa i cilësoi ata si "Kisha e sotme" dhe vlerësoi entuziazmin e energjinë e tyre.

Ai u bëri thirrje katolikëve francezë që besimin të mos e kufizojnë në një përvojë private, por ta shndërrojnë atë në një burim shprese për shoqërinë.

"Mos e mbani besimin në Jezu Krishtin vetëm për veten tuaj, por lëreni të rrjedhë për të ushqyer dhe mbushur me shpresë njerëzit që takoni", u shpreh Leone XIV.

Ai theksoi gjithashtu se besimtarët duhet ta çojnë shpresën "aty ku mbizotëron dekurajimi dhe thatësia shpirtërore".

Pas përfundimit të aktiviteteve në Paris, Papa u nis drejt Lourdes, në jugperëndim të Francës. Atje pritet të vizitojë shenjtëroren e njohur mariane dhe të drejtojë lutjen pranë shpellës ku, sipas traditës katolike, Shën Bernadeta Soubirous përjetoi shfaqjet e Virgjërshës Mari.

Qëndrimi në Lourdes përbën një nga pikat kryesore të udhëtimit apostolik të Papa Leones XIV në Francë.

Në ceremoninë e Parisit morën pjesë ish-presidenti Nicolas Sarkozy, presidenti i republikanëve Bruno Retailleau, presidentja e rajonit Île-de-France Valérie Pécresse, ish-kryeministri François Fillon, Gabriel Attal, Dominique de Villepin dhe Eric Zemmour.

Pjesëmarrja ishte parashikuar edhe për ish-kryeministrin Édouard Philippe, Marine Le Pen dhe kryeministrin aktual Sébastien Lecornu.

Presidenti Emmanuel Macron mungoi në meshë. Presidenca franceze kishte bërë të ditur më herët se ai nuk do të merrte pjesë në asnjërën prej meshave të zhvilluara gjatë kësaj vizite.

Shtuar më 26.09.2026 17:10



E rëndë në Athinë/ Tre shqiptarë rezultojnë të zhdukur pas shpërthimit t...



Përmytjet përfshijnë të gjithë Bangkokun, shpallet gjendje katastrofe në 50...



Kriza energjetike pas luftës Iran-SHBA, BE u kërkon vendeve anëtare të...



Këshilli i Sigurimit dënon sulmet e Houthis ndaj Arabisë Saudite: Goditjet...



Shpërthim i fuqishëm në Athinë, shembet ndërtesa dhe përfshihet nga zjarri, ...



Mbrojtja ajrore saudite rrëzon dy dronë dhe kap dy raketa balistike të nisura...



WSJ: Trump refuzoi armëpushimin 7-ditor të propozuar nga Teherani...



Irani propozon armëpushim 7-ditor dhe rihapjen e Ngushticës së Hormuzit:...

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.